

Roli i universiteteve në nxitjen e edukimit mbi median dhe informacion

Erlis Çela

A mund të imunizojmë qytetarin e sotëm nga fake news dhe teoritë konspirative? Jetojmë në kohë pandemie dhe terma të tilla si imunizimi dhe vaksina janë ndoshta nga fjalët më të përfolura nga të gjithë. Shkenca dhe shoqëria i ka varur shpresat e shpëtimit nga pasojat e COVID-19 pikërisht tek imunizimi i popullatës përmes vaksinës. Ndërkohë që diskutimet mbi vaksinën përbëjnë sot një nga temat më të nxehta si për shkencën, ashtu edhe për politikën, një tjetër problem i rëndësishëm kërkon zgjidhje të shpejtë. Trajtimi i problematikave që lindin nga ekspozimi ndaj produktit mediatik dhe informacionit në përgjithësi të kategorive të ndryshme të audiencës, të cilat nuk kanë njohuritë e duhura dhe aftësitë për të kuptuar, klasifikuar dhe analizuar në mënyrë kritike përmbajtjen.

Ndonëse lajmet e rreme dhe teoritë konspirative nuk janë fenomene që lindën me koronavirusin, është e qartë se me fillimin e pandemisë zërat që theksojnë pasojat negative të tyre mbi shoqërinë dhe demokracinë, janë shtuar ndjeshëm. Përpjekjet për të gjetur zgjidhje ndaj këtyre fenomeneve, të cilat tashmë po konsiderohen si kërcënim për funksionimin e demokracisë në mbarë botën, ndër të tjera, përfshijnë edhe rritjen e shkallës së njohurive të audiencës rreth medias dhe informacionit.

Analogjia e imunizimit, përtej të qenit një metaforë, është edhe një teori konkrete. Teoria e inokulimit (imunizimit), e përpunuar nga studiuesi amerikan William J. McGuire ofron një model për ndërtimin e rezistencës ndaj përpjekjeve për të bindur njerëzit, duke i ekspozuar ata ndaj argumenteve kundër besimeve dhe qëndrimeve të tyre. Teoria synon t'u ofrojë individëve kundërarargumente për të hedhur poshtë këto tentativa për bindjen dhe ndryshimin e opinionit. Disa vite më pas teoricieni i komunikimit Michael Pfau e zgjeroi modelin teorik duke e përshtatur për audiencat që janë të ekspozuara ndaj fushatave dhe mesazheve politike. Studiues të tjerë pas viteve 2000 i kanë përshtatur të dhënat e teorisë së inokulimit për të kuptuar nëse edukimi mbi median dhe informacionin mund të ndihmojë në luftën kundër lajmeve të rreme.

Studiuesit S. Mo Jones-Jang, Tara Mortensen dhe Jingjing Liu vënë në dukje faktin se kjo teori sugjeron që ekspozimi paraprak ndihmon audiencën kundër sulmeve që mund të ndodhin në të ardhmen. Nëse e analizojmë këtë mburojë në kontekstin e lajmeve të rreme, atëherë mund të dalim në përfundimin se, duke ofruar njohuri dhe aftësi për t'i rezistuar kësaj kategorie

informacionesh dhe për ti interpretuar në mënyrë kritike ato, edukimi mediatik u mundëson individëve të "imunizohen" kundër çdo ndikimi të dëmshëm, që mund vijë prej tyre.

Por, a është e mundur që edukimi mbi median dhe informacionin të shërbejë si një vaksinë për të imunizuar konsumatorin e përmbajtjes mediatike ndaj lajmeve të rreme dhe teorive konspirative?

Edukimi mbi median përkufizohet si aftësia për të aksesuar, analizuar, vlerësuar dhe komunikuar informacion në një larmi formash. Parimi kryesor i edukimit mbi median ka të bëjë me faktin se sa më shumë të jemi të vetëdijshëm mbi mënyrën se si funksionon media dhe si ndikon ajo tek ne, aq më shumë kontroll fitojmë mbi përmbajtjen. Duke u edukuar mediatikisht ne krijojmë premisa për t'u diferencuar nga përdoruesit tipikë të mediave që ndikohen prej tyre pa e kuptuar. Sipas W. James Potter shumica e njerëzve lejojnë që mediat të ndikojnë mendimet e tyre në mënyra për të cilat ata nuk kanë dijeni. Pikërisht sepse kjo kategori e audiencës nuk janë në dijeni të këtyre mënyrave, ato nuk mund të ndërtojnë mekanizma kontrolli mbi përmbajtjen që marrin prej mediave.

Nga kjo pikëpamje është e rëndësishme që të rritet shkalla e njohurisë që kanë njerëzit mbi median dhe informacionin, për të kuptuar efektet e medias mbi ata dhe për të fituar aftësi që ndihmojnë në kontrollin e efekteve të mediave.

Përfshirja e universiteteve

Nisur nga analogjia e imunizimit të audiencës kundër lajmeve të rreme, mund të aludohet se suksesi në krijimin e një mburojë të përgjithshme nga këto informacione, lidhet ngushtë me përqindjen e individëve të edukuar në atë shoqëri. Me fjalë të tjera, edukimi mbi median dhe informacionin duhet të jetë një proces i gjerë që synon të edukojë sa më shumë anëtarë të audiencës.

Në këtë pikë një rol të rëndësishëm luajnë edhe katedrat universitare. Nëse analizojmë situatën në vendin tonë, vihet re se vëmendja është përqendruar më tepër në përfshirjen e njohurive të medias dhe informacionit në arsimin parauniversitar. Angazhimi i aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, politikëbërësve, në përputhje edhe me rekomandimet e organizmave ndërkombëtare synon që të adresojë këtë çështje në arsimin parauniversitar. Studime të shumta dhe autorë të ndryshëm sugjerojnë që fëmijët duhet të konsiderohen me

prioritet kur flitet për edukimin mediatik. Arsyet për këtë janë të shumta, megjithatë mund të thuhet përmbledhtas se fëmijët konsiderohen si një kategori e audiencës, e cila është e pambrojtur nga ekspozimi mediatik. Nisur nga ky arsyetim, përqendrimi i vëmendjes në rritjen e shkallës së njohurisë së fëmijëve mbi median dhe informacionin, është një hap i nevojshëm. Megjithatë nëse i referohemi analogjisë që paraqet teoria e imunizimit, edukimi mediatik i një pjesë të audiencës nuk do të prodhonte efektin e dëshirueshëm për të garantuar një mburojë ndaj valës së dezinformacionit dhe konspiracioneve.

Për këtë arsye çështja duhet parë në një këndvështrim të më të gjerë. Përfshirja e arsimit universitar dhe veçanërisht katedrave të komunikimit dhe gazetarisë provimin e edukimit mediatik dhe informacionit, mund të sillte një kontribut të rëndësishëm.

Përpara se të fillojmë të mendojmë për mënyrat sesi mund të arrihet edukimi mediatik i audiencave, nevojitet të kuptojnë stadin aktual të audiencës sa i përket njohurive mbi median dhe informacionin. Pa një skanim të detajuar të situatës, dhe një analizë cilësore të nevojave që shfaqin grupe të ndryshme të audiencës, çdo hap i hedhur në drejtim të përmirësimit të njohurive mbi median dhe informacionin, mund të mos prodhojë efektet e dëshiruara. Nga kjo pikëpamje është e domosdoshme përfshirja e katedrave universitare dhe akademikëve në studimin e nivelit të njohurive dhe nevojave të audiencës.

Edukimi mbi median dhe informacionin ka nevojë të kthehet në një temë qendrorë në studimet dhe kërkimin shkencor në shkollat e komunikimit dhe medias. Efektet e mediave janë një nga temat më të studiuara në mesin e studiuesve të komunikimit dhe medias. Megjithatë në kushtet e reja të krijuara nga transformimi i komunikimit dhe ekosistemit të mediave, si rezultat i teknologjisë, është e nevojshme që kjo temë të hulumtohet në kontekstin e koncepteve mbi edukimin mediatik.

Këto shkolla duhet të luajnë një rol udhëheqës në promovimin e edukimit mediatik. Së pari, në mesin e studiuesve dhe profesorit duhet të fillojë një diskutim i gjerë për përfshirjen e kësaj fushe në kurrikulën e shkollës së komunikimit dhe gazetarisë si një nevojë për të pajisur me njohuri të kësaj fushe, gazetarët dhe ekspertët e ardhshëm të komunikimit.

Së dyti departamentet e gazetarisë dhe komunikimit mund të përfshihen në studime të mirëfillta shkencore të bazuara në analiza empirike për të kuptuar nivelin e edukimit mediatik të grupeve të ndryshme të shoqërisë. Këto studime mund të shërbejnë si pikë referimi për hartuesit e politikave të arsimit, në procesin e përfshirjes së kësaj fushe në kurrikulën parauniversitare.

Së treti është e nevojshme që të mendohet për hapjen e programeve të studimit në nivelin master për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm që do të zbatojnë kurrikulën në arsimin parauniversitar. Departamentet e komunikimit dhe gazetarisë në bashkëpunim me katedrat e edukimit në universitet mund të ndërtojnë këto programe studimi.

Së katërti është e rëndësishme që edukimi mbi median dhe informacionin të shtrihet edhe në programet e tjera të studimit, në universitete. Studentët e programeve të mjekësisë, infermierisë, dhe programe të tjera kanë nevojë të njihen me mënyrën si funksionon media, prodhimi i informacionit dhe procesi i efekteve të medias.

Ndërhyrja në kuadrin ligjor të arsimit të lartë do të mundësonte një liberalizim të kurrikulave në universitete. Kjo do të krijonte mundësinë që studentët të kishin mundësi të zgjidhnin lëndë që janë përtej programit dhe departamentit ku ata studiojnë. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që një student i inxhinierisë, ekomomikut apo drejtësisë, të merrte lëndën e edukimit mbi median dhe informacionin nga departamenti i komunikimit apo gazetarisë. Nga ana tjetër njohuritë për median që do të marrin studentët, do të rrisin aftësitë e tyre për të ushtruar kontroll mbi përmbajtjen mediatike, ndaj së cilës ekspozohen çdo ditë dhe do ti ndihmojnë për të kuptuar si ndikon media te individit dhe shoqëria.

Të gjitha këto hapa mund të garantojnë gjithëpërfshirjen e aktorëve relevantë në përpjekjen për të nxitur edukimin mbi median dhe informacionin të shoqërisë.

Në përpjekje për të shpjeguar arsyen se pse duhet të dimë më shumë për median dhe informacion, Potter thotë se sa më shumë të jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si veprojnë mjetet e komunikimit masiv dhe si ato ndikojnë tek ne, aq më shumë fitojmë kontroll mbi efektet. Kjo na ndihmon të do të diferencoheni nga përdoruesit tipikë të mediave, të cilët kalojnë një pjesë të madhe të jetës në media pa qenë të vetëdijshëm.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program "Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans" is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM.